



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Bulevardi "Zogu I", Godina 57/2, Nr.18 Tirane

Tel/Fax 04 2226814 ; 2226814

Nr. 352/6 prot.

Tiranë 16 . 07 . 2015

V E N D I M

Nr. 71 Datë 16 / 07 / 2015

**Mbi përfundimin e procedimit administrativ, filluar me urdhrin e verifikimit
nr. 352/2, datë 22.05.2015**

Bazuar në urdhrin e verifikimit nr. 352/2, datë 22.05.2015 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil "Për verifikimin e ligjshmërisë së aktit nr. 148 prot, datë 05.02.2014 "Njoftim për ndërprerje të marrëdhënieve të punës", të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, si dhe në mbështetje të neneve 11 e vijues të ligjit nr. 152/3012 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe neneve 16, pika 6 dhe 34 të Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V Ë R E J:

Ish punonjësja, ***** , ka qenë e punësuar pranë Shërbimit Gjeologjik Shqiptar në pozicionin "Specialist" në Sektorin e Vendburimeve Metalore në Drejtorinë e Burimeve Minerale. Marrëdhënia e punës ka filluar në datë 24.08.2009 në bazë të aktit nr. 686 prot. datë 25.08.2009 "Emërim në punë" dhe ka vijuar normalisht deri në datën 05.02.2014, moment ky kur me shkresën nr. 148 prot. datë 05.02.2014 të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar "Njoftim për ndërprerje të marrëdhënieve të punës", i është njoftuar ndërprerja e marrëdhënieve të punës në përfundim të afatit të njoftimit, në datën 05.04.2015.

Përpara fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, deri në datë 26.02.2015, marrëdhëniet e punës të personelit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar nuk i nënshtroheshin fushës së zbatimit të ligjit nr. 8459 datë 11.11.1999 "Për statusin e nëpunësit civil", i ndryshuar, apo ndonjë ligji tjetër të posaçëm. Për pasojë, marrëdhëniet e punës

rregulloheshin sipas ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "*Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar.

Nëpërmjet njoftimit për ndërprerje të marrëdhënieve të punës, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, në cilësinë e palës punëdhënëse, ka shprehur vullnetin për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me ish punonjësen, ***** , akt i nxjerrë në bazë të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "*Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, që sikurse u përmend më sipër, përbënte dhe kuadrin ligjor të zbatueshëm për rregullimin e marrëdhënieve të punës në atë periudhë.

Duke mos qenë dakort me zgjidhjen e marrëdhënies së punës, mbi pretendimin se ajo ishte zgjidhur në mënyrë të menjëhershme të pajustificuar dhe pa u respektuar procedura e zgjidhjes së kontratës së punës, në datën 06.05.2014, ankuesja ***** , bazuar në dispozitat e ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "*Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, dhe në përputhje me ligjin nr. 49/2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*", ka paraqitur padi pranë Gjykatës Administrative të shkallës së parë Korçë, duke kërkuar detyrimin e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar për ta dëmshpërblyer me 2 muaj pagë për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës (në bazë të nenit 144/5 të Kodit të Punës), me 2 muaj pagë për mosrespektim të afatit të njoftimit në zgjidhjen e kontratës së punës (në bazë të nenit 143/1 të Kodit të Punës), me 12 muaj pagë për zgjidhje të menjëhershme dhe pa shkaqe të justifikuara të kontratës së punës (në bazë të nenit 155/3 të Kodit të Punës), si dhe shpërblimin për vjetërsi në punë në masën e 2 pagave mujore (në bazë të nenit 145 të Kodit të Punës). Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, Gjykata Administrative e shkallës së parë Korçë, bazuar në dispozitat e ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "*Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, me vendimin nr. 385 datë 30.06.2014, ka vendosur pranimin e pjesshëm të padisë duke detyruar palën e paditur, Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, të paguajë në favor të paditëses ***** dëmshpërblimet përkatëse prej 2 muaj pagë për mosrespektim të afatit të njoftimit, 2 muaj pagë për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së marrëdhënieve të punës, pagën e 6 muajve neto si dëmshpërblim për zgjidhje të menjëhershme të pajustificuar të kontratës së punës dhe 2 paga mujore, si shpërblim për vjetërsi për çdo vit pune të plotë. Ligjshmëria e vendimit për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, pra nëse organi shtetëror në zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, ka respektuar ose jo ligjin e zbatueshëm, materializuar në aktin nr. 148 prot, datë 05.02.2014 "*Njoftim për ndërprerje të marrëdhënieve të punës*", i është nënshtruar juridiksionit gjyqësor dhe vazhdon ende të jetë objekt i shqyrtimit gjyqësor, pasi kundër vendimit të sipërpërmendur, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar ka ushtruar ankim pranë Gjykatës Administrative të Apelit dhe ky vendim nuk ka marrë formë të prerë.

Referuar nenit 141 të Kodit të Punës "*Kontrata me kohëzgjatje të pacaktuar përfundon kur zgjidhet nga njëra palë dhe ka përfunduar afati i njoftimit*". Kjo dispozitë e interpretuar gjerësisht edhe nga Gjykata e Lartë me anë të Vendimit 19, datë 15.11.2007 të Kolegjeve të Bashkuara nënkupton që ligji e lë në diskrecionin e secilës prej palëve (në vullnetin e njëanshëm të secilës palë) për të ndërprerë kontratën, duke respektuar afate të caktuara taksative njoftimi. Në kuadër

të jurisprudencës së konsoliduar gjyqësore, por edhe doktrinës në fushën e marrëdhënieve të punës që rregullohen nga dispozitat e Kodit të Punës, punëdhënësi ka të drejtë t'i japë fund marrëdhënieve të punës duke respektuar procedurën (neni 144 i Kodit të Punës) dhe afatin e njoftimit (neni 143 i Kodit të Punës). Çdo pretendim që rrjedh nga zbatimi ose jo i këtyre dispozitave i nënshtrohet juridiksionin gjyqësor, dhe është pikërisht ky i fundit, që zgjidh pasojat që derivojnë si rezultat i zgjidhjes së marrëdhënieve të punës të rregulluara nga Kodi i Punës.

Ankesa e **** nuk i referohet ndonjë shkeljeje konkrete të legjislacionit që rregullon fushën e shërbimit civil, e konkretisht ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij. Për më tepër, kërkesa për rishikim të vendimit për ndërprerje të marrëdhënieve të punës materializuar në aktin nr. 148 prot. datë 05.02.2014 të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar dhe rikthim në pozicionin e mëparshëm të punës, ngrihet mbas një periudhe kohore prej më shumë se një vit nga data e aktit të njoftimit të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, ndërkohë që akti në fjalë dhe pasojat e tij bazuar në dispozitat e ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "*Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, janë shqyrtuar dhe i janë nënshtruar tashmë juridiksionit gjyqësor, si organ kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Nga ana tjetër, në vështrim të nenit 36, paragrafi 3, të ligjit nr. 8116 datë 23.09.1996 "*Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, që përcakton se asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje që është duke u gjykuar nga gjykata, kur një çështje është në juridiksionin e një organi, nuk mund të shqyrtohet njëkohësisht edhe nga një juridiksion tjetër.

Duke mbajtur në konsideratë se:

- në momentin e daljes së aktit nr. 148 prot, datë 05.02.2014 "*Njoftim për ndërprerje të marrëdhënieve të punës*", legjislacioni i zbatueshëm ishte ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 "*Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar, dhe pozicioni i punës së ***** nuk ishte pjesë e shërbimit civil;
- forma dhe procedura e ndjekur për nxjerrjen e aktit nr. 148 prot. datë 05.02.2014 "*Njoftim për ndërprerje të marrëdhënieve të punës*" është realizuar përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, dhe për pasojë kjo vendimarrje është rregulluar sipas ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "*Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë*", i ndryshuar;
- shqyrtimi i ligjshmërisë së aktit nr. 148 prot. datë 05.02.2014 "*Njoftim për ndërprerje të marrëdhënieve të punës*", nën dritën e ligjit të zbatueshëm, i është nënshtruar juridiksionit gjyqësor dhe është marrë në shqyrtim nga Gjykata Administrative;

Për këto arsye,

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenet 11 e vijues të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe në nenin 34 të Rregullores “*Mbi Procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*” të miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015,

V E N D O S A:

1. Përfundimin e procedimit administrativ të Urdhrit të Verifikimit nr. 352/2, datë 22.05.2015 “*Për verifikimin e ligjshmërisë së aktit nr. 148 prot, datë 05.02.2014 “Njoftim për ndërprerje të marrëdhënieve të punës”*”.
 2. Të njoftohen për këtë vendim Shërbimi Gjeologjik Shqiptar dhe ankuesja ***** .
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA